



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina

### EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

të mbledhjes së parë të Kuvendit, mbajtur më 08.01.2021, e cila filloi në orën 10:00.

**Në mbledhje morën pjesë:** Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit, këshilltarët e Kuvendit: Vala Peshku, shefe e GP-së (PSD), Drilon Pireva (PSD), Genc Sherifi (PSD), Mimoza Sylejmani (PSD), Qëndrim Sahiti (PSD), Bashkim Beha (PSD), Adrian Berisha (PSD), Leonora Shabani - Bajraktari, shefe e GP-së (LVV), Vjosa Hamiti - Krasniqi (LVV), Arbër Vokri (LVV), Mirsad Vitia (LVV), Egzon Azemi (LVV), Besnik Mujeci (LVV), Naim Hoxha (LVV), Nazlie Bala (LVV), Halim Halimi, shef i GP-së (LDK), Sami Salihu (LDK), Milazim Vitija (LDK), Shefqet Osmani (LDK), Agim Gashi (LDK), Shefki Gashi (LDK), Haki Dragusha (LDK), Vlora Dumoshi (LDK), Elmire Nikçi - Rexha (LDK), Naime Osmani (LDK), Mustafë Krasniqi (LDK), Kushtrim Sopa (LDK), Hafiz Krasniqi (LDK), Kumrije Shabani - Ramadani (PDK), Leutrim Retkoceri (PDK), Muhamet Selmani (PDK), Florida Canolli (PDK), Suzan Kika, (PDK), Fadil Gashi, shef i GP-së (AAK), Valbona Ajeti (AAK), Bukurie Canolli (AAK), Fiknete Bejta (Grupi i pavarur), Vesel Makolli, shef i GP-së (AKR), Sami Boroci, (AKR), Arbenita Murseli (AKR), Adelina Fazliji (AKR), Valbona Petrovci (e pavarur), Rifat Deri (i pavarur) dhe Sokol Berisha (Grupi i pavarur).

**Munguan:** Migjen Shala (PDK), Jeta Rafuna - Hasani (LDK), Visare Gashi (PSD), Nol Nushi (PSD), Blerand Stavileci, shef i GP-së (PDK), Kreshnik Smajlaj (Grupi i pavarur) dhe Granit Shala (Nisma).

**Të pranishëm ishin edhe:** Shpend Ahmeti, kryetar i Komunës, Selim Pacolli, nënkryetar i Komunës, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Medina Braha, drejtoreshë e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Blerta Basholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Kulturës, Fatime Hajdari, drejtoreshë e Drejtorisë së Parqeve, Venera Morina, përfaqësuese e Drejtorisë së Financave, Osman Bllaca përfaqësues i ekzekutivit, përfaqësues të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësues të OJQ-ve, përfaqësues të KFOR-it, dhe përfaqësues të medieve.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues i Kuvendit.

Para se të fillonin me diskutimet për rendin e ditës, kryesuesi e ftoi z. Muhamet Selmani që ta bëjë betimin para Kuvendit.

Kryesuesi hapi diskutimin për rendin e ditës.

**Agim Gashi** tha se sa i përket propozimvendimit për revidimin e Planit rregullues "Kodra e Diellit", kam marrë një shkresë nga Ministria e Kulturës, e cila ka kërkuar nga Komuna e Prishtinës të vazhdojë procedurën e shqyrtimit të lokacionit për ndërtimin e Teatrit të Operës dhe Baletit, dhe përmes kësaj kërkesë ka kërkuar që Komuna e Prishtinës ta japë këtë pronë në shfrytëzim afatgjatë.

Faqe 1 nga 7

Ai kërkoi që, në rast se ka gatishmëri, të futet në rend dite për shqyrtim, ose ta marrim një përgjigje nga përfaqësuesi i Qeverisë i cili do të sqarojë se çka ka ndodhur me këtë kërkesë. **Vlora Dumoshi** tha se prona në afërsi të Fakultetit Teknik është parcelë e alokuar për ndërtimin e Teatrit të Operës dhe Baletit, bazuar në vendimet e Kuvendit Komunal të Prishtinës, gjegjësisht për caktimin e lokacionit për ndërtimin e Teatrit të Operës dhe Galerisë së Arteve në Prishtinë. Me këto vendime kjo parcelë është dhënë në shfrytëzim të përhershëm Ministrisë së Kulturës, me të njëjtin vendim janë ekzekutuar parcelat në fjalë, është regjistruar në emër të Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit, dhe ende prona është në emër të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit në pjesën e kadastrit. Kërkoj që Plani rregullues në mënyrë se si është hartuar, të mos votohet, sepse është në kundërshtim me Planin zhvillimor urban dhe më tepër nuk është në interes të Komunës dhe Kosovës.

**Rifat Deri** tha se ka më se dy vjet që kam kërkuar të formohet një komision, i cili do të merret me analizimin e rrugëve dhe institucioneve në komunën e Prishtinës, por nga kjo punë nuk është bërë asgjë, ose të paktën unë nuk e di se është bërë gjë. Nuk e kam të qartë si dhe ku i kanë gjetur emrat, pastaj edhe emërtimet të një pjese të rrugëve dhe institucioneve të Prishtinës.

Propozoj që emri i bibliotekës "Hivzi Sulejmani" të ndërrohet dhe të shtihet si pikë e rendit të ditës në "Bibliotekat e qytetit të Prishtinës". Po ashtu, propozoj që të ndërrohet edhe emri i rrugës "Vojo Kushi".

**Shefki Gashi** tha se në seancën e fundit të Kuvendit u miratua një vendim për lirimin nga pagesat të qytetarëve që lëvizin me autobusë. Konsideroj se është bërë një diskriminim që nuk ndodh askund, sepse ata që lëvizin me trafikun urban nuk paguajnë, ndërsa ata qytetarë të cilët lëvizin me linjat e kontraktuara private, që vijnë nga Keçekolla, Mareci, Mramori, Bërnica, Barileva, Hajvalia, këta duhet me paguar. Kërkoj që ky vendim të rishqyrtohet edhe një herë.

**Egzon Azemi** propozoi që në rend të ditës të futet edhe pika: "Propozimvendimi për ndalimin e ndërtimeve në gjithë zonën e Peizazhit të mbrojtur të Gërmisë, deri në miratimin e Planit menaxhues të parkut".

**Sami Boroci** kërkoi nga ekzekutivi që për pikën e gjashtë të rendit të ditës, e që ka të bëjë me Planin rregullues të Fakulteti Teknik, të jepet një sqarim më i hollësishëm rreth pronësisë së asaj parcele.

Po ashtu, shprehu pakënaqësi rreth vendimit për lirimin e qytetarëve, të cilët udhëtojnë me autobusë të Trafikut Urbanë, duke thënë se ai vendim u aprovua pa menduar mirë. Nëse Komuna dëshiron me u marrë me këtë çështje, atëherë pajtohem se duhet përfshirë edhe pjesët tjera e jo vetëm qendra e qytetit të cilën e mbulon Trafiku Urban.

**Leutrim Retkoceri** falënderoi kryetarin dhe ekzekutivin që ka pasur vullnet dhe e ka zbatuar vendimin e Kuvendit, mirëpo ky vendim do duhej të ishte i plotë, në rast se është tre muaj, dhe të përfshihen gjithashtu edhe linjat të cilat nuk kanë qenë të përfshira me Trafikun Urban, siç janë linjat: 10 A, 3 A, 7 B, 5, 6 etj. Nëse Kryetari nuk përgjigjet brenda 10-15 ditëve nga kjo seancë, atëherë ne do të kërkojmë përsëri që të ketë një vendim të ri dhe ta kompletojë këtë çështje deri në muajin mars, sepse ashtu edhe ka qenë propozimi i parë.

**Naime Osmani** tha se pothuajse në asnjë fshat të Gollakut nuk kemi linja të trafikut urban, andaj kërkoj që të merren parasysh edhe kërkesat e atyre banorëve të mos jenë të diskriminuar. Kërkoj nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që t'i kryej obligimet ndaj qytetarëve të atyre zonave, pra që edhe ata ta kenë një shërbim sa më të mirë me linjat e transportit.

**Muhamet Selmani** tha se pika e cila ka të bëjë me Planin rregullues të Fakulteti Teknik, propozoi që kjo të shtyhet për mbledhjen e ardhshme dhe gjatë kësaj kohe të kemi një interpretim ligjor të saktë rreth parcelave të propozuara dhe të definohet pronësia e tyre se kjo parcelë a është në fakt pronë e Ministrisë së Kulturës apo jo. Nëse parcelat komunale jepen në shfrytëzim për kohë të caktuar dhe plani i caktuar nuk ekzekutohet brenda afatit për të cilin është dhënë nga Komuna, Kuvendi e gëzon të drejtën që ta kthejë prapë pronën në pronësi të Komunës.

Lidhur me vërejtjet e ngritura rreth këtij propozimvendimi, sqarime të nevojshme dha **Genç Bashota**, drejtor.

**Halim Halimi** tha se në mungesë të Hartës zonale, lindin dilema të tilla rreth definimit të pronave. Mbetem prapa saj që për fakultete është vendi adekuat, por do të jetë vendi edhe për Ministrinë e Kulturës, pasi që aty e kanë një pronë të vetën, dhe jepet mundësia që të dyja edhe Ministria e Kulturës, edhe pjesa tjetër e fakulteteve të kenë vend aty. Duke pasur parasysh dilemat e ngritura rreth këtij lokacioni, propozoj që në emër të grupit kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër. Do të ishte mirë që Ministria e Kulturës dhe Komuna të kontaktojnë mes veti, në mënyrë që të gjendet një zgjidhje e kënaqshme për të dy palët.

**Drilon Pireva** tha se kërkesat të cilat u prezantuan nga parafolësit, mendoj se ato nuk qëndrojnë, pra ndërtimi i atyre objekteve për fakultete është në interesin publik. Unë nuk jam kundër ndërtimit të objekteve kulturore etj., mirëpo shfrytëzimi se si është duke iu bërë kësaj teme, mendoj se është e pandershme. Propozoi që sa më shpejtë kjo pikë të hidhet në votim.

**Naim Hoxha** propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për ndonjë mbledhje tjetër, dhe të diskutohet në mes Ministrisë dhe Komunës në gjetjen e ndonjë zgjidhjeje të mundshme, sepse jemi institucione të të njëjtit vend me një interes të përbashkët për këtë çështje.

Lidhur me vërejtjet dhe shqetësimet e ngritura nga parafolësit, rreth vendimit të Kuvendit për lirim të qytetarëve nga pagesa në trafikun urban, sqarime shtesë dha **Selim Pacolli**, nënkryetar i Komunës.

**Agim Gashi** tha se jam i vetmi asamblist që e kam tërheq vëmendjen lidhur me vendimin për lirim të qytetarëve nga pagesa në trafikun urban. E kam thënë se në çoftë se është fjala për linjat e Trafikut Urban është keq, nëse është fjala për linjat ku operojnë të gjitha ndërmarret për shërbim të udhëtarëve të komunës së Prishtinës, është në rregull.

I kam shkruar edhe kryetarit dhe aty nuk e kam votuar atë vendim, sepse e kam parë që termin "transport urban" po e ngatërroni me Trafikun Urban si ndërmarrje. Do të ishte mirë që kur të vërehen gabimet të përmirësohen ato.

**Fiknete Bejta** bëri vërejtje rreth vendimit të miratuar në Kuvend për lirim të qytetarëve nga pagesa, e cila propozoi që, duke filluar nga seanca e radhës, ta bëjmë praktikë që asnjë propozimvendim të mos merret pa u kalkuluar, dhe mos të merret pa u sqaruar ndikimi dhe impakti që do të ketë ai propozimvendim. Jemi të vetëdijshëm që një pjesë e popullatës së qytetarëve të Prishtinës janë të diskriminuar në aspektin e mungesës së linjave të trafikut urban, prandaj kisha kërkuar që Kuvendi dhe ekzekutivi të bashkëpunojnë, në mënyrë që mos të na sjellin propozimvendime të papërgatitura.

**Kryesuesi** kërkoi nga ekzekutivi që materialet të cilat diskutohen në mbledhjen e Kuvendit, të jenë të përgatitura dhe të formuluar ashtu si duhet, në mënyrë që të kenë pastaj gabime terminologjike dhe përmbajtjesore.

**Kryesuesi** i hodhi në votim propozimet:

Propozimi i parë, tërheqja e pikës së gjashtë nga rendi i ditës: "Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën tek Fakulteti Teknik, në lagjen "Bregu i Diellit" në Prishtinë.

**Kryesuesi** konstatoi se më 20 vota për, 15 kundër dhe 3 abstenime, hiqet nga rendi i ditës "Propozimvendimi për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën tek Fakulteti Teknik, në lagjen bregu i Diellit në Prishtinë".

Propozimi i dytë "Ndryshimi i emrit të bibliotekës, nga "Hivzi Sulejmani" në "Bibliotekat e qytetit të Prishtinës".

**Kryesuesi** konstatoi se më 22 vota për, 4 kundër dhe 7 abstenime, futet në rend të ditës për diskutim ndryshimi i emrit të bibliotekës nga "Hivzi Sulejmani" në "Bibliotekat e qytetit të Prishtinës".

Propozimi i tretë, "Propozimvendim për ndalimin e ndërtimeve në gjithë zonën e peizazhit të mbrojtur të Gërmisë deri në aprovimin e planit menaxhues të parkut.

**Kryesuesi** konstatoi se më 18 vota për, 12 kundër dhe 4 abstenime, hyn në rend të ditës për diskutim: "Propozimvendimi për ndalimin e ndërtimeve në gjithë zonën e peizazhit të mbrojtur të Gërmisë deri në miratimin e Planit menaxhues të parkut".

**Kryesuesi** propozoi që të mos shtohet si pikë në rendin e ditës: "Propozimvendimi për lirim të qytetarëve nga pagesa në trafikun urban, meqenëse Kryetari ka marrë vendim për një muaj, d.m.th. për muajin dhjetor, që ka kaluar, dhe propozimi tjetër është që të zgjerohet edhe për të gjitha linjat tjera të trafikut urban.

Kryesuesi konstatoi se më 33 vota për, 5 kundër dhe 1 abstenim, me ndryshime dhe plotësime, u miratua ky

### **Rend i ditës:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
2. Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike;
3. Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2019;
4. Informatë nga Drejtoria e Parqeve mbi menaxhimin e hapësirave të gjelbra dhe parqeve në Komunën e Prishtinës;
5. Propozimvendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01-464/01-263767/18, dt. 01.11.2018, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës;
6. Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme, për vitin 2021;
7. Propozimvendimi për formimin e komisionit për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021;
8. Diskutim lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Termokos", SHA, Prishtinë;
9. Propozimrregullorja e punës së Këshillit drejtues të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona";
10. Propozimrregullorja për caktimin e procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim për më pak se një vit;
11. Propozimvendimi për ndryshimin e emrit të bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në emërtimin "Bibliotekat e Qytetit të Prishtinës";
12. Propozimvendimi për subvencionimin e çerdheve me bazë në komunitet;
13. Propozimvendimi për ndalimin e ndërtimeve në gjithë zonën e Peizazhit të mbrojtur të Gërmisë, deri në miratimin e Planit menaxhues të parkut;
14. Pyetje dhe përgjigje;
15. Të ndryshme.

Para se të fillohet me diskutimin e pikës së parë të rendit të ditës, Valbona Petrovci ngriti një shqetësim rreth diskutimit për Planin rregullues për zonën e Fakulteti Teknik, e cila tha se Teatri i Operës dhe Baletit e ka shumë më të përshtatshme një hapësirë në qendër të qytetit, siç e kanë të gjitha vendet e botës, e jo atje ku u propozua nga parafolësit, andaj konsideroj që dy objekte të rëndësishme kaq të madhe nuk mund të jenë në një vend.

#### **Pika e parë**

**Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.**

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 30 vota për, u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së pestë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës.**

#### **Pika e dytë**

#### **Informatë nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.**

Lidhur me Informatën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike, të pranishmit i njoftoi **Medina Braha**, drejtoreshë.

Ajo kryesisht u fokusua në shërbimet e kësaj drejtorie gjatë vitit 2020. Në vazhdim ceku se për shkak të pandemisë, në pjesën më të madhe të këtij viti kemi punuar me staf të reduktuar, andaj gjatë kësaj periudhe shërbimet publike janë ofruar rregullisht. Janë ofruar shërbime si në larjen e rrugëve, është bërë dezinfektimi i hapësirave publike, janë riparuar hapësirat e 4 nënkalimeve në qytet, kemi bërë largimin e deponive ilegale, mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve dhe trotuareve. Kemi vazhduar në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik, mirëmbajtjen e monumenteve dhe fontanave.

Projekt tjetër është ngritja e vendkalimeve për këmbësorë dhe vendosja e paneleve ndriçuese, sinjalizimi vertikal dhe horizontal i rrugëve, furnizimin dhe montimin e shtyllave anti - parking dhe rrethojave, si dhe ngjyrosjen e tyre. Kemi bërë rrethimin e varrezave në komunën e Prishtinës, në tërë hapësirat publike, grumbullimin e mbeturinave në territorin e komunës së Prishtinës. Gjithashtu, kemi punuar në pastrimin e shtretërve të lumenjve, kolektorëve atmosferikë, kanaleve të hapura dhe përroskave, si dhe kemi bërë vendosjen e kapakëve të ujëmbledhësve, si dhe disa shërbime të tjera.

**Agim Gashi** theksoi se fusha e shërbimeve publike është mjaft e gjerë, sepse prekë secilën pore të jetës brenda administratës komunale dhe qytetarëve të komunës.

Qëllimi im i parë është që hapësirat gjelbëruese brenda qytetit të trajtohen me më shumë përkushtim, mbeturinat të grumbullohen, mos të hidhen kot, por të dërgohen në pikën grumbulluese.

Hapësirat gjelbëruese dhe parqet e vogla të mirëmbahen më mirë, po ashtu të bëhet edhe krasitja e drurëve, ku ka drurë të gjatë mbi ndërtesat 5 katëshe, që në aspektin e emergjencave paraqesin një rrezik permanent.

Mendoj se ka edhe gjëra të tjera, por megjithatë raporti është korrekt dhe ne duhet ta përkrahim drejtorinë për aq sa ka arritur, duke marrë parasysh edhe vërejtjet që po i japim këtë vit për t'i tejkaluar ato.

**Adrian Berisha** tha se shumica e problemeve që ndërliken me ankesat e qytetarëve që kanë të bëjnë me shërbimet që i bën kjo drejtori, ku shumica e qytetarëve ankohen për këto shërbime, duke përfshirë mbeturinat në qytet, mungesa e ndriçimit publik, rreziku nga qentë endacakë, vendosja e kontejnerëve, mosfunksionimi i rregullt i ashensorëve në banesat kolektive. Po ashtu, do të ishte mirë që të shikohen, analizohen edhe një herë disa rrugë njëkahore në lagjen "Dardania", që si pasojë e tyre po shkaktohen tollovi në komunikacion, si dhe vendosja e pritoreve të autobusëve, mendoj se janë shumë të papërshtatshme dhe nuk janë të vendosura mirë. Gjithashtu, edhe montimi i skajoreve orientuese në rrethotullim në lagjen "Arbëria" në fakt nuk ka bërë ndonjë zgjidhje të duhur.

Hapësirave gjelbëruese duhet t'u jepet një prioritet në mirëmbajtjen e tyre, mirëmbajtja e varrezave etj. Pra, kjo drejtori duhet të marrë masa për tejkalimin e gjendjes së krijuar. **Nazlije Bala** theksoi se në bazë të këtij dokumenti dhe këtij informacioni, fokusi kryesor i ofrimit të shërbimeve po ndërlidhet vetëm tek sheshi dhe tek rrethi i parë dhe i dytë i Prishtinës, por shumë lagje dhe pjesë të tjera të qytetit anashkaolohen. Për nga sasia e fletëve ka shumë ky dokument si informacion, por nga cilësia e informacionit kemi mangësi shumë të mëdha dhe ky dokument - informacion është një tentim për ta përmbledhur punën e drejtorisë përmes improvizimit të fotografive. Konsideroj se ky informacion ka improvizime dhe jo informacione të detajuara.

**Muhamet Selamani** njoftoi për një kërkesë të kahershme të banorëve të fshatit Barilevë, të cilët kanë kërkuar që të bëhet rregullimi dhe thurja e varrezave, por deri më tani nuk kanë marrë asnjë përgjigje dhe varrezat kanë mbetur në gjendje të mjerueshme. Propozimi i lokacionit të ri që është i dedikuar për ndërtimin e varrezave, po shfrytëzohet nga qytetarët e pandërgjegjshëm si deponi për grumbullimin e mbeturinave të ngurta. Kërkoj që kjo kërkesë të trajtohet urgjentisht. Po ashtu, kërkoj një informacion të plotë për objektet dhe parkingjet në bashkëpronësi, sidomos tek ndërtesat e reja, ku qytetarët janë të tmerruar me gjendjen e parkingjeve.

**Valbona Ajeti** theksoi se në rrethrotullimin te kryqëzimi i rrugëve "Muharrem Fejza" dhe rruga "B", vendosja e skajoreve orientuese në atë rrethrotullim e ka përkeqësuar edhe më shumë gjendjen në komunikacion, andaj kërkoj që të analizohen edhe një herë vendosja e atyre skajoreve orientuese. Po ashtu, shqetësuese në këtë lagje është edhe mungesa e ndriçimit të rrugëve, si dhe rreziku nga qentë endacakë.

**Sami Boroci** kërkoj të dijë se a është bërë ndonjë analizë apo studim në lidhje me vendosjen e skajoreve orientuese në disa rrethrotullime, pasi që prapë po mbetet trafiku i ngarkuar. Një vërejtje që vlen të veçohet, janë edhe pritoret për autobusët e trafikut urban, pasi që janë shumë të papërshtatshme ndaj reshjeve atmosferike. Kërkoj të dijë se a ka plan edhe jashtë qytetit me u vendosur ndonjë pritore, si në Hajvali, në lagjen "Kodra e Trimave", dhe në disa lagje të tjera të Prishtinës. Po ashtu, do të ishte mirë që sa më urgjent të intervenohet në eliminimin e rrezikut nga qentë endacakë, si dhe të intervenohet në ndalimin e deponive ilegale.

**Fiknete Bejta** tha se sipas këtij raporti shihet se kjo drejtori ka pasur punë voluminoze, ka treguar një përkushtim, edhe pse ka hapësirë për vërejte e kritika. Kërkoj të dijë se a ka përfunduar kontrata e renovimit të rrugës "Xhemail Mustafa" dhe a është bërë pranimi teknik i saj. Po ashtu kërkoj që në mënyrë urgjente të bëhet shenjëzimi i rrugës dhe të ndryshojnë shenjat e komunikacionit në këtë rrugë, si dhe të hiqet rrethrotullimi nga aty pasi që është i papërshtatshëm për komunikacion.

**Shefki Gashi** duke pasur parasysht se kjo drejtori ka menaxhimin e trotuareve, sipërfaqeve publike, në fakt pjesa periferike e qytetit nuk po trajtohet fare, kështu që rruga nga Xhamia e Llapit e deri në rrugën "Haxhi Zeka" ka më se dy vjet ato rrugë janë bërë të pakalueshme.

Një projekt i rrjetit të kanalizimit që ka filluar para katër viteve në fshatin Mramor, ende nuk ka përfunduar. Më se i domosdoshëm është rregullimi i trotuarit në fshatin Llukar, si dhe shumë projekte të tjera që janë të nevojshme për qytetarët.

**Sami Salihu** ngriti tri shqetësime rreth shërbimeve që i kryen kjo drejtori.

Ka më se shtatë muaj që në lagjet: "Dardania", "Kalabria", "Kodra e Trimave" e shumë lagje të tjera të Prishtinës nuk ka ndriçim publik, andaj kërkoj të dijë se ku qëndron problemi.

Shqetësimi tjetër është në lidhje me caktimin e hapësirës për kontejnerë në lagjen "Pejton", konkretisht në rrugën "Robert Doll", aty në tunel, por një biznes për interesa të veta personale i ka larguara ata kontejnerë, i ka zhvendosë në një lokacion tjetër, por është zvogëluar hapësira e parkingut për ata banorë. Po ashtu, në parkun regional afër Gërmisë, Komuna e Prishtinës i lejon kompanisë së ndërtimit "Tregtia" që të hapë deponi të dheut. Deponi me materiale inerte janë krijuar edhe afër Zllatarit dhe te liqeni i Badovcit.

**Naime Osmani** tha se vendbanimet jashtë qytetit po anashkalohen dhe nuk po trajtohen ashtu si duhet. Në fshatin Besi ndriçimi publik nuk funksionon. Një shqetësim që vlen të theksohet është edhe vendosja e numrave të shtëpive, që janë bërë pa asnjë kriter. Mungojnë pritoret në stacionet e autobusëve në fshatin Besi dhe Rimanishtë. Po ashtu, rruga Besi-Rimanishtë është shumë e ngushtuar dhe është më se e domosdoshme që të pastrohet anash, të prehen drurët që rruga të jetë më funksionale.

**Jeta Rafuna** tha se ka më se shtatë muaj që rruga "Haxhi Zeka" është pa ndriçim. Gjithashtu me rastin e vendosjes së numrave të shtëpive, ata numra janë vënë pa asnjë kriter dhe për këtë kërkoj që të korrigohet vendosja e tyre. Po ashtu kërkoj urgjentisht që të merren ndonjë iniciativë për eliminimin e rrezikut nga qentë endacakë, ku prezenca e tyre paraqet rrezik për qytetarët. Pastrimi i disa rrugëve po anashkalohet, kështu që rruga "Abedin Rexha" ka më se katër vjet që nuk është pastruar.

**Naim Hoxha** bëri vërejtje rreth disa shërbime të kësaj drejtorie, duke thënë se në vendndaljet e autobusëve në ato pritoret e tyre mungojnë hartat të cilat duhet të tregojnë për linjat e autobusëve. Sa i përket menaxhimit të varrezave, mendoj se është një aplikacion ideal për me u realizuar në sistemin kompjuterik, ku secila familje mundet ta ketë një shenjë me të cilën qaset dhe e kërkon varrin e të vdekurit. Po ashtu, do të ishte më se e nevojshme që pastrimi i pusetave të jetë më në nivel. Vërejtje që vlen të veçohet janë edhe numrat e shtëpive të cilët janë vendosur pa asnjë kriter. Kërkoj që këto vërejtje të merren parasysh nga kjo drejtori.

**Arbenita Murseli**, kryesisht u fokusua rreth kamerave të sigurisë në qytet, duke thënë se vendosja e tyre duhet të shtrihet edhe në pjesët e tjera të qytetit e jo vetëm në qendër. Po ashtu, do të ishte mirë që vendosja e pritoreve për autobusë të shtrihet edhe në lagjet dhe zonat e tjera, si p.sh. në lagjen "Mati", "Kodra e Trimave", Hajvali etj., pra janë të domosdoshme për të mirën e qytetarëve të Kosovës.

Lidhur me vërejtje dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha **Medina Braha**, drejtoreshë.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Informata nga Drejtorja e Shërbimeve Publike.**



## Pika e tretë

### Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2019.

**Halim Halimi** tha se sa i përket procesit të përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, shihet se është bërë sipas legjislacionit në fuqi, por me përjashtim të një keq klasifikimit të shpenzimeve, të cilat kanë ndikuar në theksimin e çështjes. Mendoj se është dashtë që Komuna sipas rekomandimit të Auditorit që e ka pasur edhe për vitin paraprak 2018, t'i zbatojë ato rekomandime. Prej 21 rekomandimeve, 6 janë zbatuar në tërësi, 2 pjesërisht, 3 rekomandime janë konsideruar të mbyllura, ndërsa 10 rekomandime nuk janë adresuar fare, por duhet pasur parasysh për herët tjera, që rekomandimet të cilat i jep Zyra e Auditorit Kombëtar duhet zbatuar.

Sa i përket shpenzimit të buxhetit, nuk është shpenzimi i buxhetit i kënaqshëm, kur dihet se është shpenzuar vetëm 71% e buxhetit. Në bazë të këtyre gjetjeve të Auditorit të Përgjithshëm, mund të konstatojmë se Komuna ka dështuar sa i përket planifikimit, do të thotë kur të bëhet planifikimi i mirë bëhet edhe realizimi i mirë, kur nuk është planifikimi i mirë është vështirë edhe me menaxhuar. Kjo ka çaluar në menaxhim dhe në mbikëqyrjen e realizimit të projekteve, sidomos projekteve kapitale.

**Mirsad Vitija** theksoi se në bazë të të gjeturave të Auditorit, do t'i nge disa shqetësime dhe do të kërkoj llogari nga kryetari dhe menaxhmenti i Komunës. Raporti nxjerrë konkluzione se janë vërejtur dobësi evidente në fusha të rëndësishme financiare, si në të hyrat, në shpenzimet, obligimet e arkëtueshme, si dhe pasuritë jo financiare. Ai gjithashtu vë në pah se përgjigjja ndaj rekomandimeve të vitit paraprak nuk është adresuar në nivelin e kërkuar. Prej 21 rekomandimeve, 6 ishin zbatuar, 2 ishin zbatuar pjesërisht, 3 janë konsideruar të mbyllura, ndërsa 10 rekomandime nuk ishin zbatuar fare, dhe kjo tregon se sa i përgjegjshëm është Kryetari i Komunës! Raporti gjithashtu tregon se përmes planifikimit buxhetor Komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime në kategori ekonomike jo adekuate, sepse përgjegjësia bie pikërisht mbi menaxhmentin dhe Kryetarin e Komunës.

Raporti po ashtu paraqet shqetësim lidhur me trendin e ulët të shpenzimit të buxhetit nga ekzekutivi. Po ashtu, shohim të gjetura të shumta të natyrave të ndryshme, si tek faturimi i tatimit në pronë, vonesat në lëshimin e lejeve të ndërtimit, vonesat në realizim të projekteve etj. Në bazë të këtij raporti mund të konstatojmë se ka edhe shumë të gjetura të tjera rreth menaxhimit jo të drejtë të pronave komunale etj.

**Leutrim Retkoceri** tha se në bazë të këtij raporti mund të konstatojmë se si arrihet që kaq pak nga buxheti i Komunës së Prishtinës të realizohet, e posaçërisht të realizohet në investime kapitale. Ky është një dëm i pariparueshëm që i bëhet Komunës së Prishtinës.

Nëse për 6 vjet pronat e Komunës së Prishtinës që shfrytëzohen pa asnjë kompensim për Komunën, ato po shfrytëzohen tani, janë shfrytëzuar para 6 vjetëve, janë shfrytëzuar edhe para 4 vjetëve. Prishtina sot më së paku ngjan si kryeqytet falë qeverisjes së dobët, e qeverisjes populiste që i ka pësuar këto dy mandate.

**Sami Boroci** theksoi se raporti i Auditorit është një pasqyrë për Komunën e Prishtinës, e cila është dashtë me na shërbyer, me na përmirësuar qeverisjen dhe shumë procese brenda Komunës. Gjithmonë auditori gjen diçka, mirëpo shqetësues është adresimi i këtyre gjetjeve.

Sa i përket investimeve kapitale, e kemi pa edhe në raportin financiar 3 mujor, është një problem që një kohë të gjatë, jo veç në këtë qeverisje, por buxhet të pa shpenzuar kemi pasur edhe në qeverisjen paraprake.

Faturimi në pronë jo i njëjtë për të gjithë qytetarët, gjithashtu një çështje tjetër është edhe lejet e ndërtimit, ku pritet një kohë shumë e gjatë për me u pajisur me një leje të ndërtimit, dhe kjo ndikon në procesin e punës për ato projekte, por ndikon shumë edhe në të hyrat e Komunës për këtë periudhë të caktuar. Pra është një raport i pakualifikuar, pra mendoj se kërkesa ime është që këto gjetje me u adresuar dhe me u marrë shumë më shumë me to.

**Fiknete Bejta** tha se ky raport i auditorit është i pamodifikuar, që në një raport të auditimit kjo është shumë me rëndësi, mirëpo nuk janë të pa rëndësishme edhe gjetjet dhe çështjet që janë theksuar në raport. Ky raport ka trajtuar dokumentet financiare dhe materialin, ku ka treguar për disa të gjetura, të cilat për nga pesha e tyre nuk ndikojnë në vërtetësinë ose relevancën e materialeve financiare.

Ne si asamblistë duhet të paraqesim shqetësim për disa çështje lidhur me keq klasifikimin e shpenzimeve të një kategorie jo adekuate, disa lëshime që kanë të bëjnë me aplikimin e tatimit në pronë.

Çështje tjetër është faturimi i tatimit në pronë jo në pajtim me udhëzimet administrative, vonesat në lëshimin e lejeve të ndërtimit e që kjo çështje që trajtuar dhe sipas ZKA-së. Mos trajtimi i kësaj çështje mund të krijojë dëmtrim të investitorëve, por edhe dëmtrim të buxhetit të Komunës. Po ashtu një e gjetur e raportit të ZKA-së është edhe shfrytëzimi i pronave publike nga bizneset pa asnjë kompensim, pra duhet të merren me shqetësim disa çështje që janë theksuar nga ZKA-ja dhe duhet zbatuar në përpikëri rekomandimet e auditorit.

**Shefki Gashi** tha se sipas sugjerimit të këtij raporti, mund të konstatojmë se pothuajse në të gjitha fushat auditori ka dhënë komente e tij, pra gjithkund e paraqet përgjegjës Kryetarin e Komunës, sepse asnjë projekt nuk është përfunduar sipas auditorit në gjendjen 100% pozitive siç duhet të përfundohet.

**Egzon Azemi** theksoi se sa i përket raportit të auditorit, shihet se problemi kryesor ka qenë rreth menaxhimit të pronave, e që Komuna humb më se 5 milionë euro çdo vit. Nëse e kalkulojmë me shumën minimale të qirasë në zonën industriale, pra zona ku ishte dashtë me lulëzuar bizneset, Komuna po humb jashtëzakonisht shumë miliona euro. Po ta krahasojmë shpenzimin e buxhetit me qeverisjen e kaluar, mund të konstatojmë se trefish është shpenzuar më shumë buxheti në secilën kategori sesa tani me këtë qeverisje.

**Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin 2019.**

**Pika e katërt**

**Informatë nga Drejtoria e Parqeve mbi menaxhimin e hapësirave të gjelbra dhe parqeve në komunën e Prishtinës.**

Lidhur me Informatën e Drejtorisë së Parqeve mbi menaxhimin e hapësirave të gjelbra dhe parqeve në komunën e Prishtinës, të pranishmit në pika të shkurtra i informoi **Fatime Hajdare**, drejtoreshë.

**Sami Boroci** falënderoi drejtoreshën për prezantimin e informatës, dhe pyeti se a është paraparë ndonjë plan konkret për ndërtimin e parqeve në pjesën e vjetër dhe në pjesën e re të Hajvalisë, duke e pasur para sysh që ajo pjesë është rritur jashtëzakonisht shumë, veçanërisht pjesa e re që tash po quhet Prishtina e Re, dhe nuk ka asnjë hapësirë ku qytetarët e asaj pjese mundën me shfrytëzuar.

**Suzan Kika** kërkoi të dijë se a konsiderohet menaxhim i hapësirave të gjelbëruara vetëm mbjellja, kultivimi dhe mbrojtja e atij ambienti. Pra me këtë dua ta ngre një shqetësim, se gjendja në periferi të qytetit, posaçërisht pjesa e sipërme e Gërmisë, Hajvalia, Butovci, Maticani, Makoci, Zllatarit etj., këto pjesë janë të degraduara. Këto pjesë periferike janë degraduar, janë bërë varreza të mbeturinave inerte, andaj këto hapësira ne duhet t'i ruajmë. Si grup parlamentar i PDK-së kërkojmë një informacion lidhur me gjendjen e periferisë së Prishtinës.

**Egzon Azemi** kërkoi të dijë arsyen pse Drejtoria e Parqeve është injoruar krejtësisht në menaxhimin e parqeve, mendoj se është dashtë që edhe Drejtoria e Kulturës të ketë një bashkëpunim me Drejtorin e Parqeve rreth menaxhimit të këtyre hapësirave gjelbëruese.

**Fiknete Bejta** tha se sa i përket Drejtorisë së Parqeve, mendoj se është drejtoria që ka realizuar më së shumti buxhet gjatë planifikimeve të saj në realizimin e projekteve të tyre, dhe mendoj që ne duhet ta inkurajojmë që të vazhdojë punë për këtë kohë të mandatit sa i ka mbetur.

**Drilon Pireva** pyeti se Drejtoria e Parqeve e përkrah apo jo ndërtimin e Parkut të aventurave. **Shefki Gashi** propozoi që në pjesën e epërme të fshatit Grashticë, vendi i quajtur Ugriat, aty është një terren sportiv të trajtohet ajo pjesë me gjelbërim, të mbillen drurë, të vendosen karrige. Mendoj se aty mund të bëhet një park shumë i mirë.

**Adrian Berisha** kërkoi të dijë se çka do të ndodh me parkingun e LDK-së te kompleksi "Qafa", a do t'i kalojë si parking i vetëm i LDK-s, apo si do të trajtohet ajo hapësirë. Po ashtu një shqetësim që vlen të veçohet, është edhe nënshkrimi me kompaninë "Rexha", e cila kompani ka kontraktuar për kryerjen e i disa projekteve si në lagjen "Dardania", te "Qafa" dhe ende nuk i ka filluar punimet.

Gjithashtu kërkoi që NP "Hortikultura" të jetë më përgjegjëse në mirëmbajtjen e hapësirave të cilat i menaxhon ajo.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime të nevojshme dha **Fatime Hajdari**, drejtoreshë.

**Kryesuesi** konstatoi se u përkrah Informata nga Drejtoria e Parqeve mbi menaxhimin e hapësirave të gjelbra dhe parqeve në komunën e Prishtinës.

**Pika e pestë**

**Propozimvendimi për plotësim- ndryshimin e Vendimit, 01 - 464/01 - 263767/18, dt. 01.11.2018, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.**

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri, më 27 vota për, u miratua Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, 01 - 464/01 - 263767/18, dt. 01.11.2018, për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ambasadës së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Faqe 1 nga 17

#### **Pika e gjashtë**

**Propozimvendimi për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme, për vitin 2021.**

Naim Hoxha tha se çështja e këtyre normave ka mbetur identike sikurse ka qenë në vitin 2020, mirëpo, në anën tjetër, shumë pika të rregullores të vitit 2020 janë hequr prej kësaj të vitit 2021.

Pyes si do të sinkronizohet për çështje të cilat kanë qenë të rregulluara në vitin 2020, nëse ajo rregullore nuk është më e vlefshme.

Lidhur me këtë propozimvendim sqarime të nevojshme dha Venera Morina, përfaqësuese nga Drejtoria e Financave.

**Kryesuesi konstatoi se më 19 vota për dhe 1 abstenim, u miratua Vendimi për caktimin e normave tatimore të tatimit në pronën e paluajtshme, për vitin 2021.**

#### **Pika e shtatë**

**Propozimvendimi për formimin e Komisionit për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021.**

Jeta Rafuna, në emër të LDK-së propozoj Sami Salihun.

Vala Peshku, në emër të PSD-së propozoj Bashkim Behën.

Leonora Shabani- Bajraktari, në emër të LVV-së propozoj Mirsad Vitinë.

Kumrije Shabani, në emër të PDK-së propozoj Leutrim Retkocerin.

Sami Boroci, në emër të AKR-së propozoj Rifat Derin.

Në emër të Grupit parlamentar të AAK-së u propozua Valbona Ajeti.

Përfaqësues nga ekzekutivi u propozua Osman Bllaca, Luljeta Selimi përfaqësuese e Sektorit për punë të Kuvendit dhe Diellon Gjonbalaj, përfaqësues i Zyrës ligjore.

**Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 27 vota për, u miratua Vendimi për formimin e Komisionit për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2021.**

#### **Pika e tetë**

**Diskutim lidhur me raportin vjetor të Komisionit të Aksionarëve të NPL "Termokos", SHA, Prishtinë.**

Arbenita Murseli, në cilësinë e anëtares së Komisionit komunal të aksionarëve në ndërmarrjen publike lokale "Termokos" tha se qëllimi i këtij raporti vjetor të punës është prezantimi i të arriturave gjatë kësaj periudhe në realizimin e objektivave të ndërmarrjes. Gjatë kësaj periudhe parametrat tregojnë se kemi një ngritje të vazhdueshme të performancës sa i përket prodhimit të energjisë termike, pra shpërndarjes së energjisë termike tek konsumatorët, si dhe rritjes së faturimit, ku gjatë kësaj periudhe ndërmarrja ka realizuar të hyra 5.49 milionë euro, prej tyre fitim neto është 0.55 milion euro, që krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, fitimi neto është 25% më i vogël.

Përveç të gjitha atyre projekteve të suksesshme, Termokosi i ka edhe sfidat e veta, andaj krahas të gjitha këtyre, synojmë që rrjeti i ngrohjes në të ardhmen të shtrohet sa më gjerë dhe të ofrojë ngrohje kualitative për të gjithë qytetarët në vazhdimësi.

**Vala Peshku** tha se ka qenë një plan master për vitin 2020, për zgjerimin e rrjetit të ngrohtores "Termokos" edhe në lagjen "Mati 1", konkretisht rruga "C", në të dy anët e rrugës, dhe kjo nuk ka ndodhur. Kërkoj të dijë arsyen e mos realizimit të këtij plani.

**Sami Boroci** kërkoi nga anëtarët e aksionarëve që të kërkojnë nga menaxhmenti dhe bordi, t'i harmonizojnë punët me Drejtorinë e Investimeve Kapitale, që me rastin e shtrirjes së rrjetit mos me dëmtuar disa herë infrastrukturën rrugore dhe mos me krijuar kosto të madhe, sepse kjo po ndodh shumë shpesh.

**Adrian Berisha** kërkoi të dijë se kur saktësisht do të kyçen të gjitha lagjet e qytetit. A do të kishte pasur mundësi që ta kemi ndonjë dokument nga NP "Termokos", se kur planifikohet, në cilën periudhë kohore kyçja e të gjitha lagjeve të qytetit.

Po ashtu ceku se do të ishte mirë që të merret një vendim, për tre mujorin e parë të lirohen të gjithë banorët e qytetit të Prishtinës nga pagesa për 50% nga pagesa totale.

**Egzon Azemi** shprehu mendimin se më mirë është me e trajtuar një diskutim rreth një politike të fshirjes së borxheve të disa familjeve që janë me kushte të rënda ekonomike, sesa të lirohen, sepse disa prej tyre rrezikojnë edhe me u shkyçur. Po ashtu, po më duket pak shqetësuese që një e treta e të hyrave, sipas raportit që na e kanë dërguar, po shkon në paga, që shihet se është një shifër shumë e lartë, se më shumë po shpenzohet në paga sesa në shtrirjen e rrjetit.

**Naim Hoxha** ngriti një shqetësim, duke thënë se ndihma më e mirë që mund t'u bëhet qytetarëve, është që të iu sigurohen mjetet e kësaj teprice dhe të investojë për lagjet, siç është "Kodra e Trimave" dhe lagjet e tjera të cilat janë me ndërtim të ulët.

Unë mendoj dhe i jap porosi edhe këtyre aksionarëve të cilët janë në këtë ndërmarrje publike, që të mendojnë se si do ta uniformojnë konsumin e energjisë, e nxehtësisë për nxehtë qendrore në tërë qytetin e jo vetëm në lagjet profitabile.

**Shefki Gashi** kërkoi të dijë se a ka qenë ndonjë ekip nga Termokosi andej nga pjesa e Matičanit, që ka intervistuar banorët e asaj ane se a dëshirojnë të kyçen në rrjetin e nxehtës qendrore.

**Drilon Pireva** tha se do të ishte mirë që të ftohen të gjithë aksionarët, që ndoshta kishim mundur edhe me e konkretizuar si me thënë, në muajin e ardhshëm me lënë një takim me kryeshefat ekzekutiv, ku i koordinojnë këto punë infrastrukturore nëntokësore, sidomos me investimet kapitale, por edhe me shërbime publike, edhe me pjesë tjera që mos me na ndodh ky problemi, d.m.th. që po duhet me i hapur rrugët të cilat janë të posa shtruara.

**Suzan Kika** tha se qytetarët e lagjes "Bregu i Diellit", konkretisht të Xhambazët, janë ankuar se edhe përkundër që gypat janë ndërruar, ata nuk kanë nxehtë të mjaftueshme, andaj kërkoi të dijë se si do të bëhet inkasimi për atë pjesë të asaj lagjeje.

**Sami Salihu** kërkoi të dijë se a është menduar që për të ardhmen me e bërë një plan të pagesave, apo veç që qytetari të paguajë për aq sa harxhon dhe jo për metër katror.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga parafolësit, sqarime shtesë dha **Arbenita Murseli**, anëtare e komisionit të aksionarëve në NPL "Termokos".

Kryesuesi konstatoi se u përkrah Raporti vjetor i Komisionit të Aksionarëve të NPL "Termokos", SHA, Prishtinë.

**Pika e nëntë**

**Propozimrregullorja e punës së Këshillit drejtues të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona".**

Kryesuesi konstatoi se njëzëri, më 27 vota për, u miratua Rregullorja e punës së Këshillit drejtues të teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona".

**Pika e dhjetë**

**Propozimrregullorja për caktimin e procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim për më pak se 1 vit.**

Naim Hoxha bëri vërejtje për këtë propozimrregullore, duke thënë se problemi i ropozimrregullores është se në këtë ka shumë detaje që tregojnë se nuk është menduar seriozisht në hartimin e saj, si një rregullore e mirë bashkëkohore.

Mosdefinime, mospërcaktime të tilla ka plot, prandaj i kam regjistruar në secilin nen, secilin prej këtyre pikave. Edhe përkundër vërejtjeve, mendoj se kjo rregullore është shumë e rëndësishme dhe duhet të aprovohet, por vërejtjet e mia të jenë si një bazë e mirë për të diskutuar dhe për të parë alternativat në vërejtjet të cilat i kam bërë.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna nga z. Hoxha, sqarime të nevojshme dha Shpend Ahmeti, Kryetar.

Kryesuesi propozoi që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për diskutim në njërën nga mbledhjet e radhës së Kuvendit.

**Kryesuesi konstatoi se më 28 vota për dhe 1 abstenim, tërhiqet nga rendi i ditës "Propozimrregullorja për caktimin e procedurave të dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim për më pak se 1 vit".**

**Pika e njëmbëdhjetë**

**Propozimvendimi për ndryshimin e emrit të bibliotekës "Hivzi Sulejmani" në emërtimin "Bibliotekat e Qytetit të Prishtinës".**

Naim Hoxha tha se për ndryshimin e emrit të bibliotekës "Hivzi Sulejmani", propozoj që të krijohet një grup punues mes ekzekutivit dhe anëtarëve të Kuvendit, të parashohin një metodologji dhe një procedurë se si të veprohet me këto çështje.

Drilon Pireva bëri vërejtje, duke cekur se kjo pikë paraprakisht është dashtë të diskutohet në KPF, e pastaj të sillet për diskutim në Kuvend.

Shefki Gashi tha se po t'i referohemi historikut të këtij emri, mund të konstatojmë se në kohën kur janë gjykuar shumë atdhetarë, si Gjon Serreçi etj., Hivzi Sulejmani ka qenë njëri prej trupave gjykuese, prandaj për më shumë informacione mund të gjinden në arkiva, vendimet të cilat janë marrë në periudha të ndryshme dhe kush i ka udhëheq ato.

**Sami Boroci** tha se këto tema që tani po diskutohen, paraprakisht është dashtë të shqyrtohen në komitetet përkatëse, andaj kërkoj nga kryetari që ato komitete të jenë funksionale.

**Rifat Deri** tha se Hivzi Sulejmani ka qenë një ndër prokurorët që ka dënuar njerëzit vetëm për shkak të mos bindjes ideologjike, dhe mbajtja e emrit të bibliotekës për mua është tejet absurd. Kërkoj nga kryetari që inicimi i procedurës të bëhet në mënyrë ligjore, të merret vendim meritor dhe të mos bëhet asnjë gabim ligjor.

**Besnik Mujeci** tërhoqi vërejtje, duke thënë se këto probleme që kanë ndodhë pas luftës së dytë botërore dhe tani me i diskutuar në vitin 2020, është pak abnormale, andaj në vend që ne të merremi me problemet e qytetit, ne merremi me atë se a ka qenë njeri i mirë apo i keq Hivzi Sulejmani. Konsideroi se kjo nuk është e arsyeshme.

**Arbër Vokri** theksoi se nuk jemi ndoshta aq të mjaftueshëm, të kualifikuar si Asamble që t'i qasemi deri në fund zgjidhjes së këtyre problemeve. Lidhur me këtë çështje, mendoj se duhet me pasur një pajtim apo një koordinim edhe me Ministrinë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës sqarime shtesë dha edhe **Shpend Ahmeti**, kryetar.

**Genc Bashota** tha se e përkrah plotësisht propozimin e z. Rifart Deri dhe të Kryetarit, që kjo çështje të procedohet në mënyrë ligjore në institucionet përkatëse.

**Kryesuesi** tha se këtë propozimvendim do ta qesim në votim për mandatimin e ekzekutivit për sjelljen e informacioneve rreth procedurave për ndryshimin e emrave të institucioneve kulturore.

**Kryesuesi** konstatoi se më 27 vota për dhe 1 abstenim, u miratua propozimi që të mandatohet ekzekutivi për të sjell informacione rreth procedurave ligjore për ndryshimin e emrave të institucioneve kulturore.

#### **Pika e dymbëdhjetë**

**Propozimvendimi për subvencionimin e çerdheve me bazë në komunitet.**

**Leonora Shabani - Bajraktari** tha se e përkrahim këtë propozimvendim, por gjithashtu e kisha dhënë edhe një propozim, ku këto subvencione të ngritën më shumë, që të mundësohen të ofrohen shërbime, sidomos në çerdhet me bazë me komunitet, ku është shërbimi i logopedit, që mundet me ofruar gjithashtu edhe psikologun apo asistentin për fëmijët me nevoja të veçanta.

**Shpend Ahmeti**, kryetar, tha se sa i përket kërkesës për mbështetjen e pagës për logoped, ne mund ta mbështesim, por paraprakisht duhet të na silltet edhe kërkesa prej atyre institucioneve.

**Kryesuesi** konstatoi se njëzëri, më 28 vota për, u miratua Vendimi për subvencionimin e çerdheve me bazë në komunitet.

#### **Pika e trembëdhjetë**

**Propozimvendimi për ndalimin e ndërtimeve në gjithë zonën e Peizazhit të mbrojtur të Gërmisë, deri në miratimin e Planit menaxhues të parkut.**

**Egzon Azemi** tha se ne si propozues të kësaj pike kërkojmë, në emër të të dy palëve të përfshira në këtë diskutim, me e shtyrë për seancën tjetër, edhe pala që e ka kundërshtuar këtë projekt, janë pra disa OJQ për mbrojtjen e natyrës, të cilët janë kundër ndërtimit të Parkut të aventurave.

**Drilon Pireva** tha se kjo është situata kur dëshirojnë me krijuar kauza të rrejshme për mjedisin, pra kur donë me përfituar diçka, d.m.th. ideja e tyre është të ndërtojmë një ide tjetër, si rasti i Badocit, pra të ndërtojmë një kauzës qysh po shkatërrohet Gërmia, prandaj konsideroj se një iniciativë e tillë nuk qëndron dhe jemi kundër kësaj.

**Shpend Ahmeti**, kryetar, tha se Kuvendi komunal nuk ka nevojë me marrë vendime për ndalesën e ndërtimit në Peizazh, sepse është i mbrojtur me ligj, dhe janë 7 kategori të parqeve të cilat mbrohen, kështu që edhe kategoria e gjashtë është kategoria e mbrojtjes së peizazheve, pra në të cilën e kemi Gërminë dhe një peizazh tjetër në Republikën e Kosovës, të cilat mbrohen dhe janë në menaxhimin e komunave.

*Kryesuesi konstatoi se në mungesë të kuorumit diskutimet nuk mund të procedohen dhe konstatoi se mbledhja ndërpritet.*

*Mbledhja u ndërpre në orën 17:45*

*Për pikën "Pyetje dhe përgjigje", Kushtrim Sopa pyetjet dhe kërkesat i ka dërguar me shkrim.*

**Kushtrim Sopa, pyetje dhe kërkesa për drejtoreshën e Drejtorisë së Shërbimeve Publike:**

- A do të sanohen prishjet e ndriçuesve (shtyllave) elektrik në lagjet dhe rrugët e Prishtinës, të cilat për muaj të tërë kanë mbetur pa dritë, si: lagjet "Kodra e Trimave", "Arbëria", "Bregu i Diellit", "Kalabria" etj., e që besoj se jeni në dijeni edhe ju, ku po cenohet siguria e banorëve të këtyre lagjeve nga vjedhjet e ndryshme kohëve të fundit, si dhe nga qentë endacakë, që tani fatkeqësisht janë shtuar aq shumë në të gjitha pjesët e qytetit, duke shkaktuar incidente të shpeshta, si (frikë dhe kafshime) dhe asgjë nuk po ndërmerret as në këtë drejtim.
- Intervenimi me shenja statike në rrethrotullimin tek stadiumi "Fadil Vokrri" në Prishtinë, edhe pse unë e konsideroj qëllim mirë, me gjasë ka rezultuar jo i pranueshëm nga qytetarët dhe po shkakton tollovi të madhe në qytet dhe vonesa të shumta në organizimin e jetës së qytetarëve, ngase me gjasë timingu i semaforëve të vendosur tek udhëkryqi ("Qafa" - "Tophane" - "Arbëria") të hekurudha, mes lagjeve "Arbëria" - "Tophane" - tek Pallati i Rinisë dhe Sporteve, pranë objektit të Rilindjes) nuk janë të koordinuar saktë dhe studiuar mirë në harmonizim me rrethin, që po shkakton tollovi të jashtëzakonshme në qytet.
- Banorët afër rrugës "Afrim Maliqi" që hyn deri tek çerdhja (Kopshtin Shkollor), rrugë kjo e cila është bërë e ngarkuar duke e shfrytëzuar hyrjen e banorëve të asaj rruge, familjarët që i dërgojnë fëmijët e tyre në çerdhe, ani pse e kanë hyrjen përskaaj picerisë "Napoli", banorët e asaj rrugë kërkojnë që të ndihmohen, duke u bërë gjithashtu zgjidhje të përhershme familjarëve të fëmijëve që i dërgojnë ata në Kopshtin Shkollor. Me këtë situatë është i njoftuar edhe Kryetari i Komunës kohë më parë, banorët kërkojnë ndihmë nga ne si këshilltarë të Kuvendit komunal dhe juve si ekzekutiv i Komunës, për hapësira parking të lirë për banorët rezident të dy blloqeve.

**Për drejtorin e Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimin e Kontratave:**

- Gjendja e rrugëve është pothuajse në kolaps total, diku ka punime, diku prishje. Intervenimet mungojnë sidomos 2 javët e fundit:
  - a) A do të rritet numri i inspektorëve komunalë të punës për të monitoruar punimet?
  - b) A do të rregullohen pothuajse të gjitha rrugët në lagjen "Kalabria" (ish-"Emshiri")?



- c) A do të rregullohen të gjitha rrugët në lagjen "Kolovica", me theks të veçantë rruga "Hasan Rremniku" e cila u shtrua, mirëpo cilësia e punimeve ishte tmerrësisht e dobët dhe pas dy muajsh ballafaqohet me gjendje edhe më të rëndë?
- d) A do të vendosen pengesa në rrugë (policë të shtrirë) në rrugët në lagjen "Arbëria" gjegjësisht rruga "Ahmet Dërguti" ose ndryshe e njohur si Rruga e varrezave?
- e) Rregullimi i rrugëve në lagjen "Tophane", ku të gjithë ne që shfrytëzojmë rrugët e kësaj lagjeje i shohim dëmtimet e këtyre rrugëve, prerjet e asfaltit, ku tani janë krijuar gropa të mëdha në raste edhe të pakalueshme?
- f) A do të shtrohen të gjitha rrugët në fshatrat: Lebanë, Besi, Prugovc etj.?

**Për drejtorin e Drejtorisë së Sportit:**

- Pse nuk u ndihmuan të gjitha klubet sportive nga pakoja e ndihmave financiare, me theks të veçantë KF "Kosova" VR, e cila ka të aktivizuar të gjitha kategoritë e garuesve, madje edhe atë më specifike kategorinë e femrave (Seniore dhe U16).

**Për drejtorin e Drejtorisë së Inspektionit:**

- A ka mundësi që të ndalet prodhimi i furrave për bukë, të cilat prodhimin e bëjnë me naftë, ku si pasojë po shkakton ajër të ndotur dhe po i pengon madje për ajrosje qytetarët e lagjes "Dardania", gjegjësisht rruga "Ilaz Kodra".

Procesmbajtësi  
Zijadin Gashi

Kryesuesi i Kuvendit  
Agim Kuleta

